



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Fadil Dauti, nga fshati Prekaz i Epërm , 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

E PADITUR: REPUBLIKA E SERBISË – Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës
nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirim nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 867900 €

1.) Paditësit me datën 11.04. 1999 afër shtëpisë nga forcat serbe i është plagosur djali nëntë vjeçar me emrin Sinan ,te plagosurin urgjentisht e kanë dërguar ne spitalin e Mitrovicës për shërim .Nga autoritetet e spitalit prindi është njoftuar se femja i ka vdekur nga plagët e marra por kurrë nuk i është dorëzuar kufoma ndaj Sinan Dauti konsiderohet i zhdukur.

Provë : - Vërtetimi nga D.SH.M.S. 09 Nr. 580 te datës 21. 01.2009

- Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës nr.580-55 e datës 21.01/09
- Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL-72015020-00162 e datës 12.01.2009

2.) Paditësi se bashku me 6 anëtarët e familjes është detyruar ta braktis shtëpinë ne kohëzgjatje prej 2 muaj e 25 ditë, fillimisht nga shtëpia ka shkuar ne Shipol te Mitrovicës tek Bahri Dibrani ku ka qëndruar 2 muaj ditë, pastaj ka tentuar te rikthehet ne fshatin Prekaz por qe nga pasiguria është drejtuar ne fshatin Kilinë e Ulët tek Zeqir Tahiri ku ka qëndruar 10 ditë,nga aty prapë nga pasiguria jemi dal nëpër male nenë qiell te hapet kryesisht nëpër malet e fshatit Llaushë.

Paditësi nga na e forcave serbe i është djegur shtëpia 96m²,i është asgjësuar interieri shtëpiak,mobileria e 4 dhomave te gjumit,i është djegur po ashtu edhe stalla, ndërsa tokën bujqësore ne sipërfaqe prej 2 hektar nuk ka mujtur ta punoi 2 vite.

Provë :- Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 03/1/201/308 e datës 20.01.2009

Vërtetimi I Drejtorisë së Urbanizmit,325-21 i datës 12.01.2009

Provë : - Dëgjimi i paditësit anëtarëve tjerë të familjes dhe provave të tjera të cilat paditësi do të prezantoj në seancat e shqyrtimit kryesor dhe në rast nevojë të caktohet edhe eksperti përkatës.

3.) Të drejtën për kompensim paditësi e bazon në nenin 185 të LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 të të njëjtit Ligj , me të cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë të personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qenë e obliguar të pengoj aktet e vrasjes , dhunës , terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes së pasurisë së paditëses .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (neni 1 Protokollin nr. 1 , neni 2 dhe protokollin nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon që kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor të çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e dhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bjen këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesë padija e paditësit Fadil Dauti nga fshati Prekaz i Epërm , 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Qeveria e Serbisë si pasardhëse juridike e Qeverisë së më parshme që në emër të të njëjtës të kompensoj demin material dhe jo material paditësit Fadil Dautit ,nga f.sh.Prekaz i Epërm, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumen prej 700 000 €për vrasjen e djalit Sinanit në moshën 9 vjeçare
- shumen prej 9900 €për dhembjen shpirtërore dhe të munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi në qiell të hapur dhe shtëpi të huaja në kohëzgjatje prej 2 muaj e 25 ditë
- shumen prej 50 000 për shkak të pamundësuarit e kremtimit të festave fetare në shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes së kontaktit me farefis dhe të afërmit
- shumen prej 96 000 €për shtëpinë e djegur dhe të shkatërruar,ndërsa 400€për stallën e djegur,ndërsa 4000€për stallën e djegur
- shumën prej 8000 € për të teknikën e bardhe në sallon dhe mobilierin e 4 dhomave të gjumit.
- shumen prej 4000 € për pamundësimin e shfrytëzimit të tokës bujqësore në sipërfaqe prej 2 hektar për dy vite

të gjitha këto shuma me kamat ligjore që nga dita e ngritjes së padisë e deri në ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm .

Pala e paditur të paguaj shpenzimet procedurale të kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit , nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm .


1.) të bihet :

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit të paditëses në tërë çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marrë parasysh gjendjen

e vështir ekonomike te paditëses ne kuptim me nenin te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .
Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Fadil Dauti



Shtojcë :

1. Vërtetimet nga D.SH.M.S. 09 Nr. 580 te datës 21.01.2009
2. Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës , nr. 580-55 e datës 21.01.2009
3. Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL- 72015020-0016 e datës 12.01.2009
4. Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 03/1/201/308 e datës 20.01.2009
5. Vërtetimi I Drejtorisë së Urbanizmit,325-21 i datës 12.01.2009
6. 4 kopje te padisë